

## MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Pamela Qirko, anëtare e trupit gjykues dhe relatore e çështjes, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, kam votuar për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Xhemal Saliaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për arsyet si vijon:

### I. Në lidhje me kriterin e vlerësimit pasuror

**1. Lidhur me apartamentin e banimit me sipërfaqe 71.71 m<sup>2</sup>, blerë në çmimin 3,500,000 lekë,** kundërshtoj konkluzionin e shumicës në lidhje me deduksionin e arritur për vlerën e pasurisë në shumën 50,000 euro apo kundërvlerën e saj në shumën 6,350,500 lekë, si një vlerë e pabazuar në prova, e cila për rrjedhojë e ka konsideruar deklarin e subjektit të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016. Në gjykimin tim, pasi analizova shpjegimet dhe aktet<sup>1</sup> e paraqitura nga subjekti si prova, për të kundërshtuar konstatimet e Komisionit, në raport me aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, i vlerësoj si veprime dhe deklarime të kryera në harmoni me njëra-tjetrën, në lidhje me këtë pasuri, si vijon:

1- Në datën 8.4.2004, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. A.D, ka aplikuar për kredi pranë ProCredit Bank, me nr. kërkesë \*\*\*, ku ka kërkuar kredi për shtëpi në shumën 35,000 euro.

2- Në datën 29.4.2004 është lidhur kontrata noteriale<sup>2</sup> e shitblerjes midis subjektit, bashkëshortes së tij dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetas V.H për blerjen nga kjo e fundit të apartamentit me nr. pasurie \*\*\*, me sip. 71.71 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ballkoni 3.22 m<sup>2</sup>, të ndodhur në z. k. \*\*\*, me indeks harte \*\*\*, me adresë shkalla \*\*\*, kati \*\*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Vlorë, kundrejt çmimit 3,500,000 lekë.

3- Në datën 30.4.2004, pasuria është regjistruar në favor të subjektit dhe bashkëshortes së tij, sipas vërtetimit hipotekor nr. \*\*\*, lëshuar nga ZVRPP Vlorë.

4- Pas vlerësimit që i është bërë nga banka të ardhurave, shpenzimeve dhe kolateraleve për të siguruar shlyerjen e kredisë, në datën 17.5.2004 është proceduar me disbursimin e kredisë në shumën 34,300 euro dhe menjëherë kjo shumë është transferuar në llogarinë e shitësit, shtetas V.H.

5- Në deklaratën e kohës, DIPP e vitit 2004, subjekti ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie në shumën 3,500,000 lekë, si dhe kredinë bankare. Të njëjtin deklarin ka kryer edhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar.

---

<sup>1</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.9.2024, lëshuar nga ProCredit Bank, si dhe 4 kontrata shitjeje të lidhura mes shtetasve të ndryshëm dhe shoqërisë së ndërtimit “\*\*\*\*” sh.p.k., me objekt shitblerje apartamente, përkatësisht: kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.8.2004; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.9.2004; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.10.2004; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.12.2004.

<sup>2</sup> \*\*\* repertori, nr. \*\*\* koleksioni.

6- Në lidhje me diferencën<sup>3</sup> mes shumës së kaluar më tepër shoqërisë së ndërtimit dhe çmimit të përcaktuar në kontratë, rezultojnë akte të kohës, të cilët justifikojnë dhe konfirmojnë deklarinin persistent të subjektit gjatë hetimit administrativ dhe me kalimin e barrës së provës për përdorimin e kredisë me qëllim blerjen e apartamentit dhe mobilimin e tij. Referuar praktikës së kredisë, e konkretisht aktit “formular i analizës për kredi” datë 22.4.2004, pjesë e së cilës është edhe pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, e përgatitur dhe firmosur nga analisti i kredisë, ndër të tjera, citohet se<sup>4</sup>: “Klientja, përveç vlerës së shtëpisë... diferencën 1,000 euro do ta përdorë për të bërë mobilimin”. Gjithashtu, në pyetësonin e parë, subjekti ka vetëdeklaruar ndër të tjera se me kredinë 35,000 euro ka paguar blerjen e apartamentit bashkë me mobilimin.

7- Nga analizimi i veprimeve dhe deklarimeve të kohës dhe në mungesë të ndonjë aktit tjetër që të provojë të kundërtën, çmohet bindës fakti se pasuria objekt vlerësimi ka pasur vlerën 3,500,000 lekë dhe se subjekti përtej kësaj vlere i ka paguar shoqërisë së ndërtimit edhe vlerën e investimit të mobilieve. Në arritjen e këtij konkluzioni u bazova, përveç sa më lart, edhe në faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim deklarimin e shpenzimeve të mobilimit. Ky detyrim ka lindur me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 85/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049/2003”, e për rrjedhojë çmohet bindëse se diferenca e kaluar më tepër shoqërisë së ndërtimit përfaqëson vlerën e shpenzimeve të mobilimit. Gjithashtu, për vërtetësinë e çmimit të blerjes, u bazova në kontratat e ngjashme të shitblerjes të paraqitura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, të cilat provonin marrëdhënie të njëjta shitblerjeje të lidhura nga e njëjta shoqëri ndërtimi me blerës të tjerë për apartamente të tjera të ndodhura në të njëjtin pallat, ku nga vlerësimi i tyre konstatova çmim afërsisht të njëjtë me çmimin e blerjes së pasurisë nga subjekti i rivlerësimit. Çdolloj dyshimi tjetër për çmimin, qoftë edhe i arsyeshëm, nuk do të ishte i drejtë në vlerësimin e subjektit, nëse nuk është i bazuar në prova. Çmuj se qëndrimi i shumicës në drejtim të vlerësimit të pasurisë në shumën 50,000 euro (ose 6,350,500 lekë) është i pabazuar në akte zyrtare. Shumica ka arsyetuar bazuar në akte, të cilat, pavarësisht se duket se përmbajnë shënime të punonjësve të ProCredit Bank, nuk kanë ekstremitetet e një akti zyrtar (firmë titullari dhe vulë institucioni), pra nuk janë lëshuar zyrtarisht nga ky institucion. Për më tepër, konstatoj se me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të detyrimit tatimor dhe doganor”, ligji i cili ndër të tjera i dha mundësinë individëve të rivlerësojnë për herë të parë pasurinë me vlerën e tregut nga ekspertë të pasurive të paluajtshme, kjo pasuri është rivlerësuar në vlerën 4,323,969 lekë, pra në një vlerë shumë më të ulët sesa vlerësimi i shumicës për këtë pasuri në vitin 2004.

8- Gjithashtu, nuk jam dakord me qëndrimin e shumicës për sa i përket logjikës së përdorur për kreditimin ndaj subjektit dhe bashkëshortes së tij në masën 70%, e duke e konsideruar pjesën tjetër prej 30% kontribut personal për blerjen e pasurisë. Nga konsultimi me kuadrin ligjor dhe rregullativ të kohës në lidhje me kreditimin nga bankat e nivelit të dytë, nuk kam konstatuar ndonjë rregullim specifik në drejtim të paracaktimit të masës së kreditimit. Rregullorja e parë për

---

<sup>3</sup> Një diferencë rreth 880,000 lekë.

<sup>4</sup> Për më shumë referojuni seksionit “Komente të tjera mbi planin e investimit” të formularit të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve të praktikës së kredisë, ardhur në Komision me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 11.6.2024, të ProCredit Bank.

rregullimin e kredisë konsumatore dhe hipotekare për individët ka dalë në vitin 2009, miratuar me vendimin nr. 5, datë 11.2.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Pra, për sa kohë nuk ka pasur rregullim ligjor nga enti rregullator Banka e Shqipërisë, politikat e kredidhënies janë përcaktuar nga vetë banka e nivelit të dytë. Në rastin konkret, nga aktet shkresore të lëshuara nga ProCredit Bank konfirmohet fakti se bashkëshortja e subjektit ka kërkuar kreditim në shumën 35,000 euro dhe banka pas vlerësimit të kërkesës i ka kredituar bashkëshortët Saliaj në këtë vlerë. Në këtë kontekst, dëshiroj të vë theksin edhe tek kolaterali i vënë për të siguruar përmbushjen e detyrimit bankar, që është pasuria objekt vlerësimi. Në ndryshim nga shumica, e cila ka prezumuar vlerën 3,700,000 lekë, duke ngritur dyshime për mungesën e mbulimit të plotë të kredisë, konstatoj se në dosjen e kredisë të ardhur nga ProCredit Bank gjendet raporti i vlerësimit të apartamentit, i datës 6.5.2004, i lëshuar nga eksperti i pasurive të paluajtshme, z. A. K, i cili e ka vlerësuar pasurinë sipas kritereve të bankës, në shumën 45,000 euro.

**Përfundimisht**, bazuar në aktet e analizuara më lart, si dhe në legjislacionin në fuqi, kam votuar kundër qëndrimit të shumicës, duke e konsideruar atë të pabazuar në ligj dhe prova në lidhje me mjaftueshmërinë e deklaramit të pasurisë. Në gjykimin tim, subjekti ka kryer deklaramit të mjaftueshëm për kriterin e pasurisë dhe nuk gjendet në kushtet e nenit 61/3 dhe nenit 33/5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer deklaramit në përputhje me ligjin e kohës, në burimet e ligjshme që është kredia pranë ProCredit Bank dhe gjatë hetimit nuk rezultoi situatë konflikti interesi.

## **2 Në lidhje me justifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të personit të lidhur për huan e dhënë në shumën 17,000 euro, e përdorur për mbylljen e kredisë pranë ProCredit Bank në vitin 2009**

9- Kam votuar kundër vendimit të shumicës në lidhje me mosnjohjen e huas në shumën 17,000 euro nga motra e subjektit, shtetasja J.S (K), me arsyetimin si vijon:

10- Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit paraqiti akte shtesë<sup>5</sup>, të cilat jepnin informacion të detajuar në lidhje me të ardhurat e akumuluar për shkak të punësimit në shtetin grek për periudhën 2002 – 2008 të shtetasit J.K, bashkëshorti i huadhënëses.

11- Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës, vërehet se të ardhurat e akumuluar për shkak të punësimit në shtetin grek për periudhën 2002 – 2008, përkatësisht për huadhënësen J.S (K), rezultojnë të jenë në shumën 32,665 euro bruto, ndërsa për bashkëshortin e saj, shtetasin J. K, janë në shumën 36,111 euro. Pra, të ardhurat e akumuluar në total për bashkëshortët K, për periudhën 2002 – 2008, rezultojnë të jenë në shumën 68,776 euro, të cilat pas zbritjes së shpenzimeve jetike për dy persona, shuma që mbetet rezulton të jetë 22,922 euro, e mjaftueshme për të justifikuar huan e dhënë subjektit në shumën 17,000 euro, në vitin 2009. E kam vlerësuar të padrejtë në kuptim të rivlerësimit pasuror të subjektit të rivlerësimit përfshirjen e djalit të bashkëshortit të huadhënëses në vlerësimin financiar të kapaciteteve financiare të saj për të mbuluar shumën e dhënë hua. Së pari, shtetasi Th. K është fëmijë i lindur nga një martesë tjetër, e konkretisht nga martesë e bashkëshortit të huadhënëses me një shtetase tjetër, e cila duhet të ketë kontribuar gjithashtu në rritjen e fëmijës. Së dyti, nuk ka prova të drejtpërdrejta që të provojnë se

---

<sup>5</sup> Dokumentacion i lëshuar nga Institucioni i Sigurimeve Shoqërore të Republikës së Greqisë për shtetasit J.K dhe J.K.

djali ka bashkëjetuar me huadhënësen dhe bashkëshortin e saj (të atin), që të mund të justifikohet ngarkesa e shpenzimeve jetike për tre persona të familjes K. Ky arsyetim vjen në harmoni edhe me qasjen tashmë të konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>6</sup> në trajtimin e rasteve të ngjashme.

12- Për rrjedhojë, përfshirja në analizë e shpenzimeve jetike edhe për djalin e bashkëshortit të huadhënëses do të ishte joproporcionale në vlerësimin e kapaciteteve të huadhënëses për të justifikuar huan e dhënë në shumën 17,000 euro.

**Përfundimisht**, në qëndrimin tim, subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm dhe të justifikojë ligjërisht burimet e krijimit të shumës së dhënë hua në kuptim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

13- Gjithashtu, përveç sa më lart, kam analizuar dhe vlerësuar edhe mundësitë financiare të subjektit për të kursyer shumën 4,631 euro, me qëllim plotësimin e shumës 21,631 euro, të përdorur për shlyerjen e parakohshme të kredisë në datën 14.7.2009. Nga verifikimi i deklaratës së pasurisë për vitin 2008, rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar kursime e, për rrjedhojë, pretendimi se ka përdorur kursimet nuk është i bazuar. Referuar analizës financiare të kryer nga njësia ligjore në datën e shlyerjes së kredisë, subjekti rezultoi me pamjaftueshmëri financiare për të mbuluar plotësisht mbylljen e parakohshme të kredisë, me një balancë negative në shumën -437,982 lekë, balancë të cilën e kam çmuar të pamjaftueshme për të penalizuar subjektin në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit.

**3. Lidhur me justifikimin e burimeve të krijimit të shumës 1,400,000 lekë nga vëllai i subjektit, shtetasi H.S, si blerës i ½ pjesë të apartamentit me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup> në vitin 2012, të cilat janë përdorur për pagesën e këstit të dytë të apartamentit të banimit me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>, në vitin 2016**, bie dakord me qëndrimin e shumicës se vëllai i tij nuk ka pasur detyrimin të justifikojë ligjshmërinë e të ardhurave, pasi ai në cilësinë e blerësit nuk konsiderohet person tjetër i lidhur, bazuar në nenin 3, pika 14, nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në praktikën<sup>7</sup> tashmë të konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në trajtimin e çështjeve të ngjashme.

**4. Lidhur me automjetin në përdorim tip “\*\*\*\*”, blerë në vitin 2010 në shumën 2,200 euro**, kundërshtoj qëndrimin e shumicës në lidhje me vlerësimin ndaj subjektit, për arsyet si vijon:

- i. Subjekti i rivlerësimit, në ndryshim nga sa ka arsyetuar shumica, arriti të provonte ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave nga nëna e tij, duke shpjeguar bindshëm e provuar me akte se e ëma ka pasur të ardhura të përfituara si invalide paraplegjike sipas ligjit, si dhe të ardhura të tjera nga pensioni i pleqërisë, të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e automjetit.
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer fshehje të pasurisë, pasi ai e ka deklaruar përdorimin e automjetit në deklaratën e rivlerësimit kalimtar, si dhe ka konfirmuar gjatë hetimit administrativ përdorimin e tij për një kohë të gjatë.

---

<sup>6</sup> Referojuni vendimit nr. 15, datë 17.7.2019, të Kolegjit, për s.r. D. Rr.

<sup>7</sup> Për më shumë referojuni vendimit datë 24.6.2020 të Kolegjit, për s.r. Sh. K.

- iii. Edhe nëse i referohemi analizës financiare për vitin 2010, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për të përballuar blerjen e automjetit, pasi në këtë vit rezultonte me balancë pozitive.
- iv. Referuar aktit librezë e identitetit për përfituesit e statusit të invalidit, datë 27.4.2010, provohet se shtetasja H.A.S ka pasur statusin e invalides paraplegjike të grupit të parë në kohën e përfitimit të lehtësirave sipas ligjit nr. 8626/2000 dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Bazuar në këto fakte, si dhe duke i gjetur bindëse shpjegimet përfundimtare të subjektit në lidhje me nevojën që ka pasur e ëma invalide për ta shoqëruar në vizitat mjekësore duke përdorur automjetin, sikurse lejuar nga ligji, kam votuar kundër vlerësimit të bërë nga shumica në lidhje me këtë pasuri.

Sa i përket kriterit të pasurisë, në përfundim vlerësoj se mungesa e burimeve të ligjshme në shumën prej -437,982 lekë, si pamjaftueshmëri financiare për të mbuluar plotësisht mbylljen e parakohshme të kredisë, nën dritën e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk duhet konsideruar se e vë subjektin në kushtet e mosarritjes së një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

## **II. Në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional**

### **5. Dosja nr. 3, që i përket procedimit penal nr. \*\*\*/2015**

Në lidhje me këtë procedim, nuk bie dakord me vlerësimin e bërë nga shumica për moskryerjen e veprimeve hetimore ezauruese, pasi subjekti arriti të provonte se kishte kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme dhe pas konkluzionit të ekspertit të Institutit të Mjekësisë Ligjore për klasifikimin e dëmtimeve në kategorinë që sjellin paaftësinë e përkohshme në punë mbi 9 ditë, ka proceduar me pushimin e çështjes penale ndaj shtetasit N. Ll , me arsyetimin nuk janë shkaktuar pasoja penale sikurse kërkon ligji penal (plagosje e lehtë/e rëndë apo vdekje). Për më tepër, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegoi bindshëm se në lidhje me këtë çështje është proceduar edhe me kryerjen e testit të alkoolit ndaj të arrestuarit në flagrancë, shtetasit N.Ll dhe masa e alkoolit të rezultuar ka qenë nën minimumin e kërkuar për t’u proceduar penalisht, duke saktësuar se ky fakt hyn në rrethin e kundërvajtjeve penale.

### **6. Dosja nr. 4, lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*/2016**

Në ndryshim nga shumica, mbaj qëndrimin se subjekti në lidhje me këtë procedim arriti të shpjegonte bindshëm se ka kryer veprime hetimore shteruese në drejtim të shtetasit M.V dhe se në përfundim të hetimit ka rezultuar se vetë ky shtetas e ka pranuar akuzën për kundërshtimin e punonjësve të policisë.

## **7. Dosja nr. 5, lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*/2016**

Në lidhje me këtë procedim, nuk bie dakord me qëndrimin e shumicës, e cila ka arsyetuar se nga arresti i kryer herët në mëngjes, personit nën hetim, z. E.K, i është mohuar e drejta për të marrë avokat, pasi subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm se këtij shtetasi nuk i është mohuar në asnjë fazë e drejta për të pasur avokat, duke cilësuar dhe referuar në dosjen penale se ky shtetas, kur është marrë në cilësinë e të pandehurit, nuk ka pranuar vetë ndihmën e mbrojtësit.

## **8. Në lidhje me ankesën nr. \*\*\*, viti 2010, të paraqitur nga shtetasi A.V**

Nuk bie dakord me qëndrimin e shumicës për vlerësimin që i ka bërë subjektit të rivlerësimit në drejtim të ushtrimit të kompetencave të tij si prokurori më i lartë në këtë çështje, pasi shumica nuk referon se cilat kanë qenë veprimet e munguara, kompetencat e paushtruara të subjektit si drejtues prokurorie në trajtimin e çështjes objekt ankese. Në gjykimin tim, shpjegimet e subjektit i gjeta bindëse, të provuara me aktin e sigluar nga ana e tij “Vendim i prokurorit të çështjes “Për dërgimin e çështjes në gjyq”, datë 11.9.2008, sipas të cilit provohet kontrolli i ushtruar nga ai si prokuror më i lartë nëpërmjet miratimit për dërgimin e çështjes në gjyq.

## **9. Në lidhje me denoncimin e shtetasit K.C**

Nuk bie dakord me qëndrimin e shumicës për vlerësimin që i ka dhënë subjektit për rastin C dhe ndërlihdjen e tij me kushtet e konfliktit të interesit, për arsye se nuk u provua, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se bashkëshortja e subjektit ka qenë pjesë e strukturave vendimmarrëse në universitet gjatë kohës së disponimit për masën disiplinore të bashkëshortes së ankuesit, shtetasit K. C. Për rrjedhojë, edhe qëndrimi i shumicës për konflikt në dukje të subjektit të rivlerësimit, në gjykimin tim, nuk qëndron. Subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegonte dhe të provonte se si prokuror çështjeje ishte caktuar me vendim bashkimi nga drejtuesi i prokurorisë dhe se për shkak të dinamikës së çështjes dhe volumit të veprimeve çështja ishte zgjatur në kohë.

Për vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, konstatoj se subjekti i rivlerësimit, ka rezultuar se ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

**Në përfundim**, për sa kam arsyetuar më lart, çmoj se subjekti ka arritur nivel të besueshëm për të tria kriteret e vlerësimit e, për rrjedhojë, bazuar në nenin 59/1 të ligjit nr. 84/2016, kam votuar për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Xhemal Saliaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

**Pamela QIRKO**

**Relatore (Kundër)**